

Të nderuar kolegë deputetë,

Dua ta filloj fjalën time me mirënjohje dhe falënderime pa fund për të gjithë mjekët, infermierët dhe punonjësit e shëndetësisë për sakrificat e tyre dhe të familjeve të tyre në përballimin e pandemisë! Në kushte jashtëzakonisht në vështira të rrezikut për jetën, ata asnjëherë nuk kanë hezitur, me dashuri dhe me profesionalizëm, t'u shërbejnë njerëzve në nevojë në përballimin e kësaj pandemie, që vazhdon të dominojë jetën, ekonominë, lirinë dhe mundësitë tona. Këtë falënderim e kam për të gjithë mjekët. Pavarësisht nga ngjyra e tyre politike, për mua ata janë të gjithë të bardhë dhe shpresoj që vlerat e tyre njerëzore dhe intelektuale të kthehen edhe në vlera të politikës dhe të shoqërisë shqiptare.

Thënë këto, mendoj se sakrifica e tyre dhe e familjeve të tyre nuk mund të përdoret politikisht nga asnjë. Ne duhet të kemi mjaftueshmërisht skrupuj, ndërgjegje për të kuptuar që në këtë situatë pandemie, ku me mijëra njerëz kanë humbur të afërmit e tyre dhe vlerën e jetës kemi filluar ta matim me numra, duhet të kemi përgjegjësi dhe secili duhet të bëjë detyrën e tij. Ka shumë mjekë, njerëz të aftë, që e kanë lënë vendin dhe po ikin nga Shqipëria, duke shkëlqyer me aftësitë dhe ndershmërinë e tyre në vendet ku ata punojnë, në Europë, në Amerikë, në Britani, duke punuar në spitale të një niveli botëror apo edhe në institucione të rëndësishme shëndetësore, shkencore. Tek i dëgjon se si i trajtojnë problemet me profesionalizëm, kuptojmë se ku jemi dhe sa nevojë ka shoqëria jonë për ta. Prandaj do të mbështes pa hezitim çdo ligj që mbështet luftën dhe financimin kundër pandemisë, duke shpresuar që edhe ne si deputetë të kuptojmë që nuk jemi këtu thjesht për të ngritur kartonin, por jemi për të kërkuar përgjegjësi dhe transparencë. Madje pajtohem tërësisht me atë që ngriti kolegu Vasili, se është e domosdoshme që të gjitha financimet që bëhen në këtë kuadër duhet të jenë transparente dhe të pasqyrohen në të gjitha dokumentet që u përcillen deputetëve, sepse këta të fundit kanë përgjegjësinë kushtetuese për të kontrolluar mënyrën e implementimit të këtyre ligjeve dhe të financimit të këtyre projekteve. Po ashtu, ne nuk duhet të pranojmë që në masat kundër pandemisë ta ndajmë shoqërinë në dy grupe, të atyre që vendosin rregullat dhe nuk i zbatojnë ato, qeveritarë qendrorë dhe lokalë, apo pjesa dhe grupi tjetër, që janë shqiptarët e thjeshtë, qytetarët, biznesmenët, të cilët duhet t'i zbatojnë, përndryshe u vendosin përballë policin dhe gjokat. Fjala e specialistëve, e njerëzve të fushës, duhet të jetë e para dhe jo fjala e politikës në vendimmarrje, edhe të pandemisë. Pandemia, të nderuar kolegë deputetë, nuk është thjesht dhe vetëm një çështje shëndetësore, por është shumë më tepër se kaq.

Fondi Monetar Ndërkombëtar deklaroi para disa ditësh se Shqipëria është vendi më i varfër në rajon. Kjo pandemi po krijon një pandemi tjetër edhe më të rëndë, pandeminë e varfërisë, një zinxhir të shkatërrimit ekonomik, që do të jetë i vështirë për t'u rikthyer. Shumë biznese janë mbyllur dhe po shkojnë drejt falimentimit. Po ashtu, papunësia është rritur. Kemi një pandemi tjetër, largimin masiv të shqiptarëve, e cila do të ketë pasoja afatgjata sociale, ekonomike dhe politike. Mbështetja dhe lehtësimi i bizneseve është detyra imediate e qeverisë krahas masave për t'u përballur nëpërmjet vaksinimit apo rrugëve të tjera me këtë pandemi. Të nderuar kolegë deputetë, U bë një muaj që kur ngrita këtu në parlament nevojën për një qëndrim për situatën konfliktuale në rajon. Mendova që,

duke e shtruar në formën e një rezolute parlamentare, bashkë me kolegen Bardeli, kolegët Leskaj dhe Çelaj kërkova edhe mirëkuptimin dhe angazhimin e zotërinjve Balla dhe Rushaj për të arritur në një qëndrim të përbashkët që të kuptojmë se ku jetojmë dhe çfarë duhet të bëjmë. Në kohën kur të gjithë në Europë, në Britani, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, flasim me shqetësim për eskalimin e tensioneve në Ballkan, ku bëjmë pjesë edhe ne shqiptarët, mendoj dhe besoj që ky parlament ka detyrën të ketë një qëndrim të vetin dhe angazhim jashtë ndarjeve politike. Kam dëgjuar shumë aludime apo ide deri në absurditet: “Kush jemi ne që mund të bëjmë rezolutë për këtë çështje? Të flasim ne për rajonin? Ç’peshë kemi ne? Ne nuk kemi peshë as si vend. Pse duhet të merremi me këtë çështje?” Prija ime është e thjeshtë. Ne jemi Kuvendi i Shqipërisë, që duhet të përfaqësojmë interesat e Shqipërisë dhe të shqiptarëve, kemi detyrën kushtetuese që të mbajmë qëndrime në shërbim të interesit tonë kombëtar dhe jo vetëm të ngremë dorën apo të kundërshtojmë qeverinë. Detyra jonë nuk është të vazhdojmë me teatrin absurd të një debati patetik politik, duke mos njohur siç jemi dhe çfarë duhet të bëjmë.

Jemi Kuvendi i Shqipërisë, që përfaqësohet në shumë forume dhe në institucione ndërparlamentare, ku diskutohen çështjet e rajonit dhe të sigurisë. Jemi deputetë që marrim pjesë në aktivitete dhe në këto forume, ku flitet për sigurinë e Afganistanit, të Xhibutit, të Tanzanisë, të Sirisë, flasim edhe pa folur. Themi që kemi folur edhe kur nuk kemi folur. Folëm për ndryshimet klimatike dhe sigurinë kibernetike, por nuk kemi qëndrim për genocidin serb në Kosovë; nuk kemi qëndrim për situatën në Bosnjë-Hercegovinë; nuk kemi qëndrim për sa i përket situatës në Maqedoni. Deklarojmë marrëdhënie të përbashkëta me Serbinë, si partneri ynë i përbashkët në të ardhmen tonë europiane, por nuk na bën përshtypje, ama, armatosja e saj me mbi 1,8 miliardë dollarë, duke e kthyer në një kërcënim real për rajonin. Pyetja është e thjeshtë: çfarë e kërcënon Serbinë, të nderuar kolegë deputetë, në kushtet e një krize ekonomike të thellë, që investon kaq shumë, në mënyrë marramendëse, në shpenzimet e mbrojtjes? Kush e kërcënon, Rusia? Jo, se e ka aleat! NATO-ja? Aspak, sepse do ta ketë partner, ta ketë vend anëtar! Kosova? Absolutisht jo! Kush atëherë? Thjesht Ruisë i nevojitet një forcë partnere ushtarake në rajonin e Ballkanit. I duhet një partner politik, një marrëdhënie e qëndrueshme, për të kontrolluar rajonin e Ballkanit, dhe kjo është Serbia dhe serbët. I duhet një pikë konflikti rajonal dhe jo qëndrueshmëri në rajon, prandaj është edhe kundër pavarësisë së Kosovës. Putin di ta lexojë shumë mirë edhe NATO-n, edhe liderët botërorë, madje edhe mungesën e dëshirës për t’u angazhuar në një konflikt ushtarak në çdo situatë të mundshme. Ka nga ata që thonë se këtë punë e di NATO-ja, e dinë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pa dyshim që e dinë. Po ne çfarë dimë, apo duhet ta mësojmë të paktën se çfarë duhet të bëjmë? Ne nuk jemi në Aleancën e NATO-s thjesht për të bërë vizita apo për të bërë foto. Ne jemi për të ngritur zërin tonë dhe për të mbajtur qëndrimin tonë, në raport me interesin tonë kombëtar. Madje, kjo Aleancë na ofron edhe një mundësi tjetër, të drejtën e vetos, që mund ta përdorim në shërbim të interesit tonë, të qëndrimeve tona, pa diskutim në partneritet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Dje lexova se ushtritë e Kosovës dhe të Shqipërisë janë të gatshme të shkojnë në Ukrainë, në krah të Shteteve të Bashkuara të Amerikës kundër Ruisë. Këto janë absurditete! E para, me gjithë kërcënimin serioz të Ruisë kundër Ukrainës apo përdorimit si armë lufte të refugjatëve në kufirin ndërmjet Bjellorusisë dhe Polonisë, as në Poloni, as në Ukrainë, presidenti Biden dhe liderët e NATO-s nuk janë angazhuar me trupa ushtarake kundër Ruisë. Dhe kjo duhet të na bëjë të gjykojmë thellë. Ne jemi të gatshëm, kur nuk e na kërkohet; ne flasim, kur nuk na thotë njeri që duhet mendim, por, kur na troket problemi te dera jonë apo tek e vëllezërve tanë, e shqiptarëve, rrimë duarkryq, se themi: “Kemi NATO-n”, “Mendojnë të tjerët për ne”. NATO është një aleancë politike dhe ushtarake dhe, të paktën si anëtarë të saj, ne kemi të drejtën e fjalës, siç ndodh në takimet e ministrave të Mbrojtjes. Por duhet të flasim në një gjuhë, në një zë, me një qëndrim, që lidhet me interesin tonë kombëtar. Ne kemi edhe institucione sigurie intelligence të shërbimeve, kemi informacione apo edhe më shumë sesa kaq në

kuadër të NATO-s, të cilat nuk mund t'i arkivojmë pa i diskutuar dhe pa i debatuar me ata që kanë autoritetin për t'i diskutuar, edhe këtu në Kuvendin e Shqipërisë. Dikush mund të thotë që kjo është punë e qeverisë. Pa dyshim, qeveria ka punët e veta, por ky Kuvend nuk mund të jetë vend vegjetimi kur flitet për interesin kombëtar, por, në respekt Kushtetutës, ka qenë dhe është institucioni që ka miratuar strategjitë ushtarake të sigurisë kombëtare, duhet të kërkojë llogari dhe të bëjë opozitë, por jo thjesht të bëjë opozitë apo të bashkëpunojë me qeverinë. Së dyti, situata në Ukrainë duhet të na nxjerrë disa mësimë. Rusia nuk e pranon zgjerimin e NATO-s. Ballkani për Putinin ka qenë dhe ngelet backyard-i i Rosisë dhe ata kanë zgjedhur rojën, që është Serbia. Së treti, Rusia asnjëherë nuk e ka ndaluar veprimtarinë subversive karshi vendeve të NATO-s, edhe karshi Shqipërisë, por ne nuk duam të lexojmë dhe as të shikojmë. Ne nuk jemi duke fjetur në paq. Prandaj, të nderuar kolegë deputetë, ju ftoj ta diskutojmë këtë rezolutë. Në qoftë se nuk doni, mos e miratoni, por ta ndryshojmë, të dëgjojmë mendimin e Ministrisë së Jashtme dhe të mbajmë një qëndrim, sepse nuk ka kuptim që ndërkohë që të gjithë flasim për këtë çështje, ne, shqiptarët, nuk flasim.